

Trajnim në temë “Formimi i partneriteteve dhe rrjetëzimi në funksion të lobimit dhe përfaqësimit”

Më 27 dhe 28 shtator 2008 në Veles u mbajt trajnim në temë “Formimi i partneriteteve dhe rrjetëzimi në funksion të lobimit dhe përfaqësimit”. Në trajnim ishin të pranishëm 35 pjesëmarrës (10 përfaqësues nga njësitë e vetëqeverisjes lokale Shkup, Çair dhe Karposh dhe 23 përfaqësues nga organizata joqeveritare nga Shkupi dhe Tetova).

Qëllimi i trajnimit ishte të avancohen dituritë e pjesëmarrësve për krijimin e partneriteteve dhe rrjetëzimeve, praktikisht të prezantohen dhe të zbatohen veglat dhe metodat për formimin e partneriteteve dhe të mësohen shkathtësi për kyçe aktive në lobim dhe përfaqësim të interesave të bashkësive etnike dhe kyçjen sociale të tyre.

Përfaqësuesit e vetëqeverisjes lokale (këshilltarë por edhe të punësuar në komuna) arritën ti shohin përfitimet e këtij lloji të trajnimit duke e ditur faktin se ato ishin të njoftuar me temën. Në trajnim u krijuan një strukturë homogjene nga përfaqësues të organizatave joqeveritare dhe përfaqësuesve të pushtetit lokal, të cilët në mënyrë shumë aktive morën pjesë në trajnim.

Në sesion të veçantë u formuan tre grupe në nivel të komunave (Karposh, Çair dhe Tetovë) të cilët punuan në definimin e problemeve për zgjidhjen e së cilëve nevojitet partneritet nën-sektorial dhe formim i rrjetit.

Në këtë kontekst, në rajonin e komunës së Karposhit u theksua nevoja për sigurimin e kushteve dhe mundësive për afirmimin e vlerave kulturore, tradicionale dhe tjera të bashkësive etnike. Në komunën e Çairit pjesëmarrësit konstatuan se problem më i madh paraqet shkollimi i romëve – rreth 300 fëmijë nga bashkësia etnike rome që jetojnë në Çair në moshën prej 8 deri 17 vjet nuk shkojnë në shkollë. Grupi i cili punonte në problemet e komunës së Tetovës theksoi se ekziston sistem i vjetër për furnizim me ujë të komunës, kurse qytetarët e Tetovës nuk e shfrytëzojnë ujin në mënyrë racionale. Çështjet që i përpunuan grupet ishin specifike dhe paraqisnin shembull për atë se në të vërtetë ka nevojë ti kushtohet vëmendje kyçjes të qytetarëve dhe formimit të lobi rrjeteve lokale.

Në vazhdim të trajnimit, pjesëmarrësit mësuuan si ta definojnë qëllimin e lobimit, të përcaktojnë qëllime primare dhe sekondare, të mbledhin dhe analizojnë të dhëna, ta definojnë grupin qëllimor, të krijojnë mesazhe, të prezantojnë në mënyrë efektive, të ndërtojnë partneritete për lobim dhe koalicione, të planifikojnë buxhet për lobim dhe të vendosin marrëdhënie partneriteti me mediumet. Trajnimi u ndoq me diskutime dhe ushtrime interaktive.

Trajnues në trajnimin të cilin e organizoi Fondacioni Institut Shoqëri e Hapur – Maqedoni në bashkëpunim me organizatën partneritete “Vlera të përbashkëta”, ishin Mario Veljkoviç dhe Fatmir Saraçini. Trajnimi u mbulua nga MTV-ja, Radio Shkupi dhe redaksia vllahe pranë MTV-s.